



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112


Ref. nr. 01 / 1852 Dt. 23 / 11 /2020

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
Rektor

Mbështetur në nenin 25 paragrafi 2 dhe nenit 28 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Rektori i UKZ-së merr këtë

V E N D I M

1. Universiteti Publik "Kadri Zeka" Gjilan është në proces të akreditimit institucional në vitin 2020/21. Përveç këtij akreditimi, në proces janë edhe 12 programe studimore në akreditim/riakreditim.
2. Kjo punë kërkon një angazhim më të madh të stafit akademik dhe administrativ.
3. Kërkohet nga gjithë anëtarët e grupeve punuese për akreditim që të jenë në vendet e tyre të punës në orar të plotë pa përjashtim: nga ora 8 deri në 16, duke filluar nga data 24 nëntor 2020.
4. Të njëjtit duhet të jenë në gjendje gatishmërie për punë në grupet që do të caktohen për shkrimin e Raportit të Vetëvlerësimit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Angazhimi në këto grupe nuk e përjashton angazhimin për procesin e rregullt mësimor gjatë kësaj periudhe. Staf i caktuar lajmëron koordinatorin e grupit për mungesën për shkak të procesit mësimor para se grupi të mblidhet dhe për kohën e mungesës.
5. Takimet e grupeve për shkrimin e RVV duhet të jenë të përditshme, nga ora 8-16, duke nënkuptuar pushimin e drekës.
6. Mosrespektimi i këtij vendimi bartë pasoja administrative dhe financiare. Përjashtim bëjnë vetëm rastet shëndetësore, dhe të tjerët sipas vendimit të Qeverisë anti - Covid të cilët duhet të dëshmojnë gjendjen e tyre me dokumente shëndetësorë.
7. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.


Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Rektor

